



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr.186, datë 09.04.2024

PËR

KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT {...}

**DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE NË
GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DURRËS, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE, TË
SHPALLUR ME VENDIMIN NR.86, DATË 20.02.2024, TË KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 09.04.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Markelian Koça, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësisimit nga kandidati z. {...}, në procedurat për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 86 datë 20.02.2024, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr.73- nr.86 datë 20.02.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur hapjen e katërmbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimet nr. 73-81 datë 20.02.2024 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shtatë pozicione të lirë në fushën e të drejtës civile dhe për dy pozicione të lirë në fushën e të drejtës penale. Me vendimet nr. 82-86 datë 20.02.2024 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e

Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për tre pozicione të lirë në fushën e të drejtës civile dhe për dy pozicione të lirë në fushën e të drejtës penale.

2. Në këto procedura të lëvizjes paralele, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 20.02.2024, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 01.03.2024.

3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë nr.86, datë 20.02.2024 kandidon edhe z. {...} (më poshtë referuar si kandidati) gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, i transferuar përkohësisht me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

4. Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 86/2024, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.127, datë 11.03.2024, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}.

5. Me Vendimin nr. 140, datë 13.03.2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86 datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

“III Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 84, dhe 86 datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1(një) vlerësim.

IV. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ... 6. Për kandidatin z. {...} - relator z. Markelian Koça; ...”.

6. Më datë 18.03.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si vendimi 320/2020), në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

7. Brenda afatit të përcaktuar, kandidati nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes shkresave të veçanta, për kandidatin z. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykata ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

9. Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale specifike” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me anë të komunikimit elektronik të datë 19.03.2024, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidatin z. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

10. Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale specifike” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ai ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës penale, referuar gjykatave ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, informacioni u kërkua në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës informacioni i kërkuar është përcjell me anë të shkresës nr. 1818 prot., datë 20.02.2024. Nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë (-ish gjykatën e Rrethit gjyqësor Kurbin) informacioni i kërkuar është përcjell nëpërmjet postës elektronike më datë 06.06.2023 informacioni i cili lidhet për periudhën korrik 2019 - mars 2023 cila lidhet me kandidimet e hershme të z. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KRITEREVE TË KANDIDIMIT

11. Për kandidaten z. {...} u verifikua kriteri i “Përvojës profesionale specifike minimale”

12. “Përvoja profesionale specifike minimale” për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimit nr. 86 datë 20.02.2024, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”*.

13. Për verifikimin e kandidatës në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për lëvizjen paralele u mbajt parasysh se ai ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 86 datë 20.02.2024, çka do të thotë se kandidati duhet të ketë të paktën një vit

përvojë profesionale si gjyqtare në fushën e së drejtës penale gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit.

14. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesën për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ai ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018 dhe ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Kurbin deri më 06.03.2023, kur më pas u transferua me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës, ku ushtron detyrën edhe aktualisht.

15. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit “Luarasi” në datë 03.07.2008 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018. Me vendim nr. 133, datë 19.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendim nr. 146, datë 30.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Me vendim nr. 98, datë 06.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës. Me vendim nr. 102, datë 29.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i përsëritet transferimi i përkohshëm pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës, për një periudhë deri në 13.03.2025. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 4 vite. Z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

16. Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Lezhë, nga verifikimet e kryera, rezultoi se: *“Gjatë kohës që gjyqtari {...} ka ushtruar këtë funksion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin ka gjykuar çështje të natyrës civile dhe penale njëkohësisht. Kjo për faktin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin për shkak të trupës së saj gjyqësore me numër të vogël nuk ka qenë e ndarë në dhoma apo seksione konkrete për gjykimin e çështjeve që vinin për gjykim. Për këtë arsye gjyqtaret që përbenin trupën gjyqësore të kësaj gjykate gjykonin çështje civile dhe penale sipas shortit elektronik.”*

17. Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës, nga verifikimet e kryera, rezultoi se; *“ për gjyqtarin z. {...} përgjatë vitit 2023 ka gjykuar 33 çështje penale themeli dhe 114 kërkesa penale, ndërsa për vitin 2024 deri në fund të muajit janar ka gjykuar 1 çështje themeli dhe 2 kërkesa penale. Vlen të theksohet se në periudhën e gushtit 2023 gjyqtari ka qenë pjesë e grafikut për çështjet civile dhe penale me karakter urgjent”.*

18. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 86 datë 20.02.2024, ka mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës penale gjatë pesë viteve

të fundit përpara kandidimit, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

19. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

20. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “b”, të pikës 5, të vendimit nr. 86 datë 20.02.2024, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë nëse ka në fuqi një masë disiplinore.”*

21. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 28.02.2024, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.

22. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

23. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidati z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

24. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

25. “Papajtueshmëria ambientale” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të vendimit nr.86 datë 20.02.2024, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... transferimit, ..., për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”.* Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”.* Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me lëvizjen paralele, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”.*

26. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit

“Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 28.02.2024, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

27. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

28. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidaten Këshilli vlerëson se z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, duke plotësuar kështu kriterin e “*papajtueshmërisë ambientale*”.

III. KONKLUZIONE

28. Referuar kërkesave të Vendimit 320/2020, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit Këshillit nr.86, datë 20.02.2024, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kritereve formale të kandidimit të z. {...} për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

29. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kritereve formale të kandidimit për kandidatin z. {...}, konkretisht të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi në lidhje me këto kritere. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të tre kritereve të sipërpërmendura të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.86, datë 20.02.2024.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 8 dhe në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, si dhe në pikën 10, të vendimit nr.86, datë 20.02.2024, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR